



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut*

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 21.10.2014 ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Vasilika Hysi – kryetare e Nënkomisionit**

**Rendi i ditës:**

Miratimi i Planit të Punës së Nënkomisionit për periudhën 13 tetor - 24 dhjetor 2014

**Marrin pjesë:**

Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Xhemal Qefalia dhe Silva Caka

**Mungojnë:**

Arben Ristani dhe Kastriot Islami

## HAPET MBLEDHJA

**Vasilika Hysi** – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Sikurse jeni në dijeni, me vendimin nr. 66, të vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar disa ndryshime në përbërjen e këtij nënkomisioni. Kështu deputeti Pandeli Majko caktohet anëtar në vend të deputetes Ermonela Felaj. Gjithashtu, caktohet anëtar deputeti Xhemal Qefalia. Në bazë të vendimit të Kuvendit, konkretisht vendimit nr. 58 të vitit 2013, numri i anëtarëve të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut nga pesë ka shkuar në shtatë.

Sikurse keni marrë njoftim edhe nga sekretaria e Komisionit, çështja e rendit të ditës për sot është miratimi i planit të Nënkomisionit për periudhën 20 tetor deri më datën 24 dhjetor të vitit 2014. Do të doja të theksoja dy fjalë para miratimit të këtij plani pune. Plani i punës është hartuar duke pasur parasysh disa prioritete që shtrohen para Kuvendit të Shqipërisë, dhe njëkohësisht edhe para Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Kemi parasysh programin e punës që ka Kuvendi, konkretisht dhe Komisioni i Ligjeve, detyrimet që ka Kuvendi në rritjen e rolit aktiv të tij për përmbushjen e pesë detyrave ose rekomandimeve që ka lënë në Progresraport BE-ja, që janë edhe pjesë e planit të veprimit të qeverisë shqiptare. Gjithashtu, kemi parasysh fushën e veprimit të këtij Komisioni, por edhe shqetësimet që kanë qytetarët apo problematikat që kanë ngritur në takimet me ne, letrat dhe ankesat.

Për rrjedhojë, kemi vënë si prioritare katër fusha kryesore.

E para, që fillon me ditën e mërkurë, një seancë dëgjimore me shoqërinë civile dhe me organizata ndërkombëtare që kanë mbështetur shoqërinë civile, është Karta e Shoqërisë Civile. Është ideja për të parë një angazhim të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me rritjen e rolit të shoqërisë civile në procesin ligjvënës, por edhe atë që thuhet monitorues.

Së dyti, kemi planifikuar dy vizita monitoruese në institucionet e paraburgimit në Shqipëri, konkretisht në Tiranë. Arsyeja është se kemi përzgjedhur dy ditë ndërkombëtare, datën 25 tetor, që është dita ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe ne kemi dëshirë të shohim nga afër ndryshimet që bëjnë në ligjin për trajtimin e të paraburgosurve dhe dënuarve, ku

Komisioni i Ligeve një vend i ka dhënë trajtimit të grave, sa dhe si zbatohen në praktikë. Problemi i dytë është një vizitë monitoruese për të parë trajtimin në paraburgim dhe burgje në përgjithësi të të paraburgosurve të dënuar, por me fokus të veçantë edhe të fëmijët, të miturit. Kjo do t'i paraprijë qëndrimin që do të mbajmë në Kuvendin e Shqipërisë, në prag të 1-vjetorit të miratimit të Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve.

Gjithashtu, më lejoni të bëj me dije se do të shqyrtojmë edhe dy raportet e veçanta të Avokatit të Popullit. Në fakt, Kryetari i Kuvendit ka adresuar në Nënkomisionin tonë tri raporte. Dy raporte janë aktuale dhe i qëndrojnë problematikës. Raporti i tretë, i cili nuk është vënë në axhendë, është një raport, tashmë një pjesë është ezauruar, me ndryshimet që solli qeveria, me ligjin që kemi kaluar në parlament. Kështu që kemi menduar të diskutojmë raportin e veçantë të Avokatit të Popullit “Për Gjakmarrjen”, duke sugjeruar një seancë dëgjimore, ku krahas Avokatit të Popullit të ftohen përfaqësues të institucioneve, ose të linjës, të cilët kanë detyra për të përmbushur në bazë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Raporti i dytë do të jetë lidhur me personat me orientim seksual ndryshe, LGBT-të, dhe kjo është një nga rekomandimet që na ka lënë në Progresraport BE-ja.

Gjithashtu, mos harroni që në Progresraportin e fundit të BE-së i është lënë detyrë Kuvendit të shqyrtojë më me kujdes raportet e veçanta të Avokatit të Popullit. Kjo është një mundësi që Nënkomisioni të fillojë diskutimin e këtyre raporteve.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, dua t'ju tërheq vëmendjen në dy pika të tjera të programit që ju keni përpara.

Sikurse e dini, me kërkesën tonë i kemi adresuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për të na dhënë një informacion lidhur me mekanizmat ndërkombëtarë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare dhe plani i veprimit që ka Ministria e Punëve të Jashtme dhe qeveria shqiptare. Në fakt, Ministria e Punëve të Jashtme e ka sjellë informacionin brenda dy ditësh.

Më lejoni ta falënderoj për gatishmërinë dhe shpejtësinë e dhënies së një informacioni të plotë dhe shumë të detajuar, i cili do t'ju shpërndahet juve sot në rrugë elektronike që ta keni parasysh. Ky informacion do të na ndihmojë jashtëzakonisht shumë për ta përmbushur më mirë funksionin e kontrollit parlamentar, por edhe për të rritur rolin e Kuvendit të Shqipërisë në përmbushjen më të mirë të rekomandimeve që rrjedhin nga konventat që ka ratifikuar Shqipëria.

Në këtë kuadër, në bashkëpunim dhe në konsultim me ju kemi vendosur që të lëmë dy seanca dëgjimore.

Njëra të jetë për përmbushjen e rekomandimeve që dalin nga raporti periodik mbi të drejtat e njeriut, i cili është miratuar në shtator të vitit 2014 në Gjenevë. Qeveria shqiptare duhet të raportojë pas katër vjetësh, por Kuvendi ka rreth 106 rekomandime, për të cilat duhet të monitorojë për katër vjetët e ardhshëm.

Duke dashur që këtë proces të mos e lëmë në minutën e fundit, pra kur të vijë koha e raportimit, për të ndjekur në vazhdimësi sesi pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor përmbushin rekomandimet që janë lënë në këtë raport, sugjeroj që të fillojmë një proces të qëndrueshëm.

I fundit është një sugjerim që neve na ka ardhur edhe vitin e kaluar dhe lidhet me buxhetin e ri për vitin 2015. Duke e parë buxhetin nga këndvështrimi i përmbushjes së detyrimeve për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, sugjeroj të bëjmë një seancë dëgjimore me organizatat e shoqërisë civile, që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut lidhur me projektbuxhetin për vitin 2015. Nuk kam vënë afat se kur mund ta bëjmë këtë seancë dëgjimore, sepse, sikurse e dini, parlamenti miraton një kalendar më vetë për diskutimet e projektbuxhetit të vitit 2015.

Besoj se brenda këtij kalendari do të sugjerojmë, në qoftë se do të biem dakord dhe do ta miratojmë sot së bashku, edhe një seancë dëgjimore për të parë sesi buxhetimi, për shembull, gjinor ose buxhetimi i zërave, që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, duke filluar që nga ekzekutimi i vendimeve penale dhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut apo edhe respektimi i të drejtave të grupeve të veçanta, siç janë njerëzit me aftësi të kufizuara apo minoritet, gjejnë pasqyrim në projektbuxhetin e ri.

Më falni për hyrjen e detajuar, por gjykova se ishte e nevojshme të dinim paraprakisht pse janë planifikuar këto veprimtari deri në fund të vitit. Nëse ju do të keni më pas sugjerime apo rekomandime, mund t'i shtojmë përpara se të miratojmë kalendarin ose programin e punës së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

Faleminderit!

Kush e do fjalën?

**Xhemal Qefalia** – Jam plotësisht dakord me draftin që na keni paraqitur.

Mendoj se një nga shqetësimet e mëdha të personave, të cilët kanë monitoruar të drejtat e njeriut në Shqipëri, ka qenë edhe fakti i ndalimit të njerëzve në komisaritet e policisë.

Propozoj që, sipas axhendës, të programohet që ato të monitorohen drejtpërdrejt, sepse ka individë që ndalohen në komisariatet e policisë pa vendim gjyqi nga shefi i policisë, natyrisht sipas Kodit të Procedurës Penale. Mendoj që të futet në axhendë edhe pjesa për të bërë monitorime në komisariate të ndryshme.

**Vasilika Hysi** – Propozimi është shumë i drejtë. Ndoshta mund të planifikojmë për muajin dhjetor. A ta lëmë të hapur më mirë, për shkak se është edhe projektbuxheti dhe kemi parashikuar 6 seanca dëgjimore?

Mendoj se mund të bëjmë një monitorim, sidomos të disa komisariateve qoftë në Tiranë apo në ndonjë qytet tjetër në bazë të problematikës.

Faleminderit!

**Pandeli Majko** – Unë jam dakord me të gjithë programin, por me pak shqetësim shoh vizitën monitoruese te Burgu 313 dhe te Burgu 302. Mendoj që të mos jetë thjesht një vizitë, por mbase duhet vënë që në një moment të dytë ne të ulemi me drejtuesit e burgjeve dhe të diskutojmë me ta konkluzionet tona për të dyja vizitat, që të mos mbeten si vizita, ku erdhëm e pamë dhe nuk bëmë asgjë. Gjithashtu duhet të trajtojmë edhe shqetësimet që na ngriti qoftë personeli, qoftë ata që po vuajnë dënimin.

**Vasilika Hysi** – Keni shumë të drejtë.

Në vazhdim të sugjerimit të zotit Majko po shtoj edhe një tjetër, krahas raportit që do t'i paraqesim drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me komentet tona, në varësi të problematikës që do të rezultojë, ne mund t'u propozojmë edhe komisioneve të përhershme parlamentare që për zbatimin më të mirë të ligjit "Për trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar", ose Komisionit të Ekonomisë, ose Komisionit të Çështjeve Sociale, të mund të bëhen edhe ndryshime ligjore të nevojshme.

**Pandeli Majko** – Ta kenë të qartë që në fillim: ne mund të bëjmë propozime edhe për shkarkime nga puna. Ne nuk do të shkojmë atje për t'i pyetur nëse e kanë parë apo jo ndeshjen e futbollit.

**Vasilika Hysi** – A jeni dakord me planin e punës? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Ju bëj me dije se ditën e mërkurë në orën 12:00 do të zhvillojmë seancën dëgjimore me shoqërinë civile, me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe me ministrinë e linjës për kartën e shoqërisë civile që është depozituar në Kuvend. Besoj se do të dalim edhe me një

propozim për Komisionin e Ligjeve për një projektrezolutë që duhet të miratohet në Kuvendin e Shqipërisë.

Ditën e premte në orën 09:30 do të shkojmë tek institucioni i paraburgimit 313. Me këtë rast i kërkoj stafit të komisionit, këshilltarëve, të bëjnë njoftimet përkatëse tek institucioni përgjegjës për këtë vizitë monitoruese.

Faleminderit dhe ditën e mirë!

**KRYETARE E NËNKOMISIONIT**

**Vasilika HYSI**